



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
02/2020
Klinë, dt.16.03.2020

Duke u bazuar në nenin 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, botuar në gazetën zyrtare nr. 28/2008 të publikuar me dt.04.06.2008, nenin 91 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Klinës të dt. 07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/07 të datës 11.03.2020, lidhur me gjendjen e krijuar me qëllim të parandalimit nga infeksioni i Corona Virus COVID-19, si dhe vendimin nr.01/11 të datës 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, me akordimin edhe të grupit për gatishmëri emergjente të datës 16.03.2020, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 16.03.2020, merr;

V E N D I M

- AUTORIZOHET**, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente që për raste specifike për lëvizje jashtë territorit të komunës së Klinës, më qëllim të furnizimit të bizneseve më gjera ushqimore dhe sanitare, lëvizjes së personelit shëndetësore dhe rasteve specifike të lëshoje, LEJE TË POSAQME.
- Leja lëshohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, sipas kërkesave të përmendurve si në pikën 1 të këtij vendimi.
- Vendimi i është i plotfuqishëm dhe do të zbatohet menjëherë.
- Obligohet**, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente që në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe përgjegjësit tjerë ta zbatoj vendimin.

Te njoftohet:

- DSHPE;
- Policia e Kosovës- Klinë;
- Grupi për gatishmëri emergjente;
- Publiku.

